



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 229 prot.

Tiranë, më 28.01.2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 1831/1, DATË 03.08.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË
ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. FOTO ANDREA"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Foto Andrea nr. 844 prot., datë 16.03.2023, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrateve H.Ç. me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Vlorë dhe I.B. me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 1831/1 prot., datë 03.08.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Foto Andrea", bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja "29 nëntori", Rruga "Papa Kristo Negovani", Vlorë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

